



Ndërmarrja Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A
Lokačno Javno Proizvođače "Kastrioti" D.D
Local Public Enterprise "Kastrioti" J.S.C

Obiliq

Data:

Datum:

Date:


20 / 02 / 26

Nr. i Prot:

Br. Prot:

Prot. No:

I-302/26



Ndërmarrja Publike Lokale **KASTRIOTI** Sh.A

Adresa: Rr. "Vashingtoni" pn - Obiliq

Tel: +383 46666607; +383 48777624

Email: nplkastrioti@gmail.com; web: www.nplkastrioti.com

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 si dhe bazuar në Udhëzimit Administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik NR.01/2024 të nenit 4.1, 5.1 dhe 5.2, në Statutin e Ndërmarrjes me nr prot 1888/24 të nenit 36 paragrafi 36.3 si dhe vendimit me nr protokolli I-295/26 datë 19.02.2026 Ndërmarrja Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A Obiliq me datën 20.02.2026 shpallë:

KONKURS PUBLIK

Pozita: Teknik i Operimit dhe Mirëmbajtjes së Sistemit të Ngrohjes Qendrore (Kogjenerim)

Numri i punëtorëve: 6

Përgatitja shkollore: Diploma e shkollës së mesme

Orari i punës: i plotë

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj punë provuese (me mundësi vazhdimi / sipas planifikimit të ndërmarrjes)

Vendi: Obiliq

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës

Punëtori/ja angazhohet në monitorimin, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ngrohjes qendrore dhe rrjetit përkatës, përfshirë nënstacionet, gypat, pajisjet përcjellëse dhe ndërhyrjet teknike, si dhe në bashkëpunim me operatorin privat gjatë fazës së transferimit të njohurive dhe marrjes së përgjegjësisë operative nga ndërmarrja.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Kandidati i përzgjedhur do të kryejë këto detyra:

- Monitoron funksionimin e sistemit të ngrohjes qendrore dhe procesit të kogjenerimit sipas udhëzimeve operative.
- Bashkëpunon me operatorin privat në fazën fillestare të monitorimit dhe trajnimit praktik në vendin e punës.
- Merr pjesë në operimin dhe mbikëqyrjen e nënstacioneve të ngrohjes dhe pajisjeve përkatëse.
- Kryen kontrollime teknike në rrjetin e gypave, nënstacione dhe pajisje të sistemit.
- Identifikon defekte, raporton parregullsi dhe propozon masa për eliminimin e tyre.
- Kryen ndërhyrje teknike në terren, përfshirë riparime, ndërrim të pjesëve dhe intervenime sipas nevojës.
- Kryen punë të saldimit dhe montimit të gypave sipas kërkesave teknike dhe standardeve të sigurisë.

- Mban evidencë për punët e kryera dhe raporton te eprori i drejtpërdrejtë.
- Zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe përdor pajisjet mbrojtëse personale.
- Kryen edhe detyra të tjera të ndërlidhura me pozitën, sipas kërkesës së eprorit dhe nevojave operative.

Kushtet dhe kriteret minimale

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Shkollë e mesme
- Aftësi për punë në terren dhe në kushte operative.
- Gatishmëri për punë me ndërrime dhe intervenime sipas nevojës (kur ka defekte).
- Aftësi bazike për raportim dhe mbajtje të evidencës së punës.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Certifikatën nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (jo më e vjetër se 6 muaj);
- Aplikacionin për punësim, i cili merret në faqen e NPL "Kastrioti" Sh.A (i nënshkruar).
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopje të diplomës së shkollës së mesme

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes email-it zyrtar:

konkursetnplkastrioti@gmail.com

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për të vazhduar me procedurat tutje të konkursit.

Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është 15 ditë nga data e publikimit të konkursit.

Procedura e përzgjedhjes:

Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatët i nënshtrohen procedurës së testit me shkrim dhe intervistës. Vlerësimi bëhet me njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria arrihet me më së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikë nga të gjitha fazat e konkursit publik. CV-ja vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë, testimi me shkrim vlerësohet me shtatëdhjetë (70) pikë, dhe intervistimi me njëzet (20) pikë.

